



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË TRETË TË RREGULLT TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **21.05.2020 (e Mërkurë)**, në Zyrën e konferencave ne objektin e ri të Komunës, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Naim Pira (kryesues i Kuvendit Komunal), znj.Xhilsime Qamili, znj.Blerina Lubishtani, z.Jakup Demiri, znj.Idajete Pira, z.Bekim Azizi, z.Ekrem Abazi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e zyrave.

Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Më lejoni që ta përshëndes nënkryetarin e komunës, drejtorët e drejtorive dhe ju anëtar të KPF-së. Është mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa. Ju e dini që për shkak të pandemisë e cila ka ndodhur në gjithë botën, kanë qenë të pezulluara aktivitetet e rregullta. Kemi marr informacion nga MAPL-ja për me i pezulluar, të vetmet që kanë mund të mbahen kanë qenë për buxhetin dhe për pandeminë, ndërsa para do dite kemi marr informacionin, i kanë lejuar mbajtjen e seancave të rregullta edhe të kuvendit edhe të KPF-së, prandaj e kemi caktuar edhe ne këtë mbledhje. Na ka një kohë që nuk jemi takuar, ju jeni në dijeni për aktivitetet që i kemi bërë nga ana e komitetit për shpëtim në nivel komunal dhe kryetaret e partive politike e kanë dhënë kontributin. Policia e Kosovës dhe gjithë faktorët e tjerë që me kaluar sa ma mirë. Diçka të veçantë rreth këtyre takimeve nuk ka përpos nëse keni ju diçka për të shtuar para se të kalojmë në miratimin e rendit të ditës, fjala është për juve.

z.Bekim Azizi: A ka pasur teste të bëra për këto tri javë në Viti dhe sa ka qenë numri i testeve të bëra?

znj. Gjylsime Qamili: Kanë qenë 6 teste që i kemi bërë, por të gjithë janë dal negativ. Këto kanë qenë raste kontakti, por për fat të mirë janë dal negativ. Për momentin asnjë rast nuk e kemi në komunën tonë.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: Për plotësim pak. Kanë qenë edhe dy raste të Remnikut që kanë qenë me unionin e studenteve, por për fat edhe ata dy janë dal negativ.

znj.Hidajete Pira: Desha të dije në këtë shtabin emergjent: a ka pasur ndonjë doktor edhe ndonjë teknik? Besoj që ka qenë e arsyeshme me qenë.

Nënkryetari i Komunës z. Hasan Aliu: Jo nuk ka pasur. Kemi menduar se qendra operative ka pas mjek, a në shtab nuk ka pasur se ka shkuar komplet qeveria. Tash ndoshta aspektet profesionale e kanë kërkuar, por ndoshta edhe mospërvoja me pandeminë e ka bërë të veten.

Kryesuesi i z.Naim Pira: A ka dikush tjetër për të diskutuar. Pasi që nuk ka, për këtë mbledhje kemi paraparë këtë:

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dyte e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
- 2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2020.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e draft strategjisë komunale kundër dhunës në familje për vitin 2020-2023, si dhe planin e veprimit.**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullores për transparencë në Komunën e Vitisë, me kërkesën e MAPL-së.**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të planit komunal i menaxhimit të mbeturinave.**
- 6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të rregullores për menaxhimin e mbeturinave.**
- 7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të planit komunal i veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021.**
- 8. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2020, dhe raporti i punës për vitin 2019.**
- 9. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2020.**
- 10. Informatë nga zyra e prokurimit mbi planifikimin e prokurimeve për vitin 2020, raporti vjetor i kontratave të nënshkruara për vitin 2019.**

Më lejoni të ju informoj, se këto pika kanë qenë të përgatitura diku para dy muajve dhe me datë 13 kur na ndodhi rasti i kemi stopuar, kanë qenë të shtypura dhe sigurisht edhe protokollin keni mund me vërejt që ka qenë prej asaj kohe. A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutem? Pasi që nuk ka, nëse nuk ka, unë e hedhi në votim për miratim rendin e ditës. Konstatoj se me vota unanime u miratua rendi i ditës.

Si pikë të parë kemi

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dyte e Komitetit për Politikë dhe Financa**

Hapim debat: A donë dikush ta merr fjalën rreth pikës së parë.

z.Bekim Azizi: A e dimë se mbledhja e fundit për Politik dhe Financa ka qenë një mbledhje bajagi e gjatë dhe ka pasur tensione dhe ka pas fjalë që nuk i takojnë këtij vendi këtu, dhe parimisht në procesverbal shifet këtu, se ka qenë një mbledhje jashtëzakonisht normale, nuk janë paraqit as tensionet dhe le ma ato që kanë qenë jashtë kontrolli. Për këtë unë do të abstenoj.

z.Jakup Demiri: Për këtë që e cekim beka edhe unë mendoj njëjtë dhe do të abstenoj.

z.Ekrem Abazi: Unë apo çdo kush prej këshilltareve, atë që e thotë e ka thane me vetëdije të plotë. Ti nuk ke nevojë me korrigjuar askënd. Kam parë shumëherë që fjalitë e mija nuk i shkruani fare.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Vetëm një po ju garantoj, se kurrë nuk dërhy as nuk e pyes çka shkruan ose me hek a diçka të tillë. Po ndoshta është edhe problemi pak salla madhe dhe nuk po dëgjohet mirë.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: Ndryshimi i fjalisë ja humb kuptimin fjalisë se çka ka thanë, prandaj po ju preferoj dyve e keni inçizimin, merrne shenone dhe shikone procesverbalin. Nëse e ka humb kuptimin çka kanë dashtë me thanë këshilltaret, urdhëroni bane një tjetër.

z.Bekim Azizi: Anëtarët e komitetit janë ofenduar atë ditë, u thanë që janë njerëz çoban, lloj lloj termi i fjalëve është përdorur. Për atë po themë, nëse fyhen anëtarët e KPF-së dhe nuk e tërheq fjalën diskutanti, atëherë duhet të hyjë në procesverbal.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Atëherë duke pas parasysh vërejtjet të cilat u dhanë, unë po propozoj që le të merret të shiqohet edhe njëherë dhe aty ku duhet me përmirësuar le të përmirësohet në mënyrë që të mbetet edhe ai shënim në proces. Unë po e qes në votim. Kush është që të miratohet me vërejtjet që i cekem. Miratohet procesverbali.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2020,

Unë ja kisha kaluar fjalën zyrtarit financiar që ta paraqet para anëtareve këtë pikë të rendit të ditës.

z.Berat Zuka: Ne si Drejtori e Financave me kohë I kemi përgatitur, d.m.th ka qenë me 13.04.2020 të përgatitura, sepse këto në bazë të ligjit brenda një muaji përgatiten, mirëpo në fillimin kemi pas problem se Ligji për Buxhet nuk ka qenë I miratuar dhe në dy muajt e pare alokimet janë bërë duke u bazuar në Ligj të Buxhetit të kaluar nga Ministria e Financave, mirëpo edhe se ka kaluar buxheti në nivelin qendror dhe është fuqizuar si ligj, prapë alokimet e buxhetit janë bërë nga niveli qendror, në baza tremujore, si në grande ashtu edhe te kapitalet. Kur shifet niveli i shpenzimit të buxhetit, e sidomos te Drejtoria për Buxhet e Financa, është i vogël në këtë vit, për shkak edhe të situatës planin e rrjedhës së parasë nuk e kemi bërë, mirëpo direkt Ministria e Financave i alokon mjetet në baza tremujore. Në tremujorin e parë të alukuara kanë qenë 3 411 984 euro, kurse të shpenzuara kanë qenë 2 119 580 euro, duke i përfshirë 5 kategori ekonomike. Për ma shumë e keni të pasqyruar edhe në dokumentin të cilin e keni para jush.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutem?

z.Bekim Azizi: Na e dimë se ky vit i ka specifikat, sepse na ka përcjell koha e pandemisë. Do të jemi pak ma të rezervuar. Unë i kisha bërë disa pyetje, mes drejtorit i kemi marr disa përgjigje që shpesh na ka ra në kundërshtim. Tash ta shohim shembull kompensimi i të punësuarve 99,94, arkëtimi i pashfrytëzuar 1090 euro. S'po me qon peshë vlera, po po më intereson shumëherë ka qenë 0 0 dhe në diskutime me drejtorin thotë, se kjo nuk guxon me qenë ndryshe veç zero zero, sepse thotë alokohet në bazë të pagës në fillim të vitit. Tash disa herë po na mbetet kjo që nuk është 100 %. Tash a ka mundësi me ditë, qysh ka mbet kjo shumë e pa shpenzuar për paga, kur e dini saktësisht ku shkon për paga dhe aty asnjë cent nuk mund me qenë diskutabil ose me tepruar. Unë e kam diskutuar edhe ma herët kur ka pasur kësi raste. Mos është ndalesa që e ndalin në paga në arsim, që mungon dikush, por edhe ndalesa nuk mundet me hy se na e dimë se lista përgatitet dhe shkon me datë 10. Tash kur shkon lista alokohen mjetet për atë muj dhe paga duhet me na dal këtu zero zero. Më kish interesuar nëse ke informata te shërbimet kontraktuese, kodi 13 460. Më kish interesuar për sot edhe vendimet e gjykatës 26578 euro. Ku janë këto shpenzime të gjykatave dhe në raport më kish interesuar pse kësaj radhe kur është bërë krahasimi i shpenzimeve, faqe 26, në raportet tjera kur është bërë diferenca në periudhat të njëjta 2019-2020. Në mes ka qenë edhe një rubrikë, kur p.sh.: pagesat që janë bërë në vitin 2020 për tremujorë, në atë pjesë kanë qenë obligimet e tash nuk kanë hyrë obligimet hiq. Sa janë obligime që janë paguar të vitit 2019 dhe po na ik një pjesë që zakonisht ne e kemi pasur një raport që e kemi ditur në atë vlerë sa janë kanë obligime të vitit paraprak, që në këtë raport nuk janë cek fare. D.m.th pse është bërë ky ndryshim i raporteve.

z.Berat Zuka: në vitin 2019, edhe se kemi bërë e kemi bërë ndryshe, ndërsa këtu e kemi përgatitur vetëm për kategoritë ekonomike, jo në paga, ma herët e kemi përgatitur edhe në paga, mirëpo vitin e kaluar edhe këtë vit Ministria e Financave e merr edhe koston e shpenzimit në paga. Në këtë rast shuma prej 1098 euro ka mbetur në muajin e tretë se këtë muaj paga të zjarrfikësve nuk e dimë pse e kanë marrë atë shtesë dhe kjo ka mbetur prej Ministrisë së Financave, sepse tash nuk e kemi planin e rrjedhës së parasë, mirëpo në fund ata e parashohin minuset dhe pluset, janë duke I barazuar Ministria e Financave. Te shërbimet kontraktore, janë shërbime udhëtime 470 euro. Nuk e kam regjistrin, por nëse ka nevojë e sjellim edhe regjistrin. Te shpenzimet e gjykatave, nuk e kam regjistrin, por kjo është shumica nga Ministria e Arsimit që I fitojnë pagat jubilarë arsimtaret e mëhershëm. Edhe një arsytim të vogël të viti 2019. Rubrika që nuk ka dal, ju e dini se Departamenti I Financave ka punuar me një staf shumë të kufizuar, kemi qenë 6 - 7 vetë që kemi ardhur për çdo ditë, hartues kryesisht I këtyre raporteve është analisti I buxhetit, Shefki Aliu. Ai është rezervuar për ta bërë, mirëpo nëse është nevoja i prezantojmë në seancën e kuvendit.

Nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu: Më fal se po ndërhy, po në aspektin ligjor kanë bazë, por mbulesë ligjore nuk kanë qit në fond dhe ata kanë thanë, komuna duhet me i paguar, por fond nuk kanë qit fare.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Duke pasur parasysh, se trendi i pandemisë është duke ardhur dhe tu u zvogëluar, po shpresoj që po shpresoj se në seancat e radhës do të kompletohen dhe natyrisht pas gjatëmujorshit do të na vinë të kompletuara.

z.Ekrem Abazi: Ekzekutimi i buxhetit për pjesën e parë 62,12 %, mallra dhe shërbime 25.40 %, po e lidhni krejt me s 'mundjen, ndërsa kjo ka filluar ka mesi i muajit mars, d.m.th te shërbimet dhe mallrat mirë që nuk keni shpenzuar. Po më interesoj te shërbimet të ndryshme shëndetësore, p.sh.: janë 24 450 euro. Mirë që janë bërë këto shpenzime, pajisje të tjera 14 842 euro. Një sqarim për këtë, furnizime mjekësore janë bërë 7674 euro. Unë mendoj se këtu është dashtë me pas ma tepër këtë me katërfishuar, por buxheti te Drejtoria e Shëndetësisë është ekzekutuar vetëm 33%, d.m.th shkojnë qytetarët me marr një infuzion dhe të gjitha duhet me i ble vetë, po them gati të gjitha, tu e pa edhe sëmundjen edhe rastet e vështira që janë në komunën tonë, tu e pas tash edhe Virusin Korona, që ka ardhur, duhet me pas shpenzime ma të mëdha. Unë mendoj se edhe një pjesë u dashtë me marr me bart te Drejtoria e Shëndetësisë gjatë kësaj kohe e jo me lanë vetëm 33% buxhetin e hargjuar te kjo drejtori. Furnizimi me land djegëse dru, 16 243 euro. Ku janë bërë furnizime me këto dru edhe sa ka kushtuar një metër dru? Mirëmbajtja e ndërtesave, edhe këtu duhet një sqarim, ku janë mirëmbajtur këto ndërtesa. Te shpenzimet, i cekim Bekimi, por prapë po e përsërisë, te shpenzimet te shëndetësia, p.sh.: te shërbime dhe mallra 100% të shpenzuara. Unë ju kisha lutur me bart mjete prej shërbimeve dhe mallrave te shëndetësia, se ka harxhime të mëdha. Unë e kam rastin në shtëpi dhe e di shumë mirë.

z.Berat Zuka: Politikat udhëheqëse janë të drejtoritë e shëndetësisë, për atë nuk di çka them. Sa I përket për furnizim me dru, është obligim I vitit të kaluar, i prezantuar edhe në borxhe. Mirëmbajtja e ndërtesave, hynë këtu gjitha objektet e komunës.

z.Jakup Demiri: Te kodi 14032, mirëmbajtja e rrugëve lokale. A është një tender që ka qenë mirëmbajtja dhe rregullimi i varrezave, është mbi 16 mijë euro.

z.Nexhmedin Jakupi: Na i kemi dy projekte që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e rrugëve, është njëra për mirëmbajtjen e rrugëve të dimrit dhe mirëmbajtja e rrugëve verës dhe pastrimi i qytetit dhe hapësirave gjelbëruese.

Nënkryetari i Komunës z. Hasan Aliu: Në përfundim të kësaj pasqyre, duhet me cek si vërejtje, aty si vërejtje, p.sh.: të nderuar këshilltar komunal, pasiçë rënia e shkallës së të hyrave vetanake, rënia e donacioneve, shkalla e ulët e investimeve dhe diferenca e shpenzimeve të cilat janë ma të vogla krahasuar me periudhën e vitit të kaluar është si rezultat i pandemisë, i shpallur nga ana e OBSH-së dhe Komuna e Vitisë është e karantizuar. Është mirë me gjetë edhe ndonjë shprehje tjetër. Unë besoj se ky dokument duhet të ketë këtë.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Ju faleminderit për diskutim. Pasi që kjo pikë nuk votohet, kalojmë në pikën tjetër.

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e draft strategjisë komunale kundër dhunës në familje për vitin 2020-2023, si dhe planin e veprimit

znj.Ibadete Hyseni: Kjo draft strategji është fokusuar në tri komponentë të cilat janë: parandalim, mbrojtje, riintegrim i viktimave të dhunës në familje; ku këto komponente janë kryesore për në këtë strategji. Në këtë draft kemi bërë një analizë të situatës aktuale, ku janë diskutuar disa faktor për lehtësimin e kësaj strategjie. Unë nuk do ta zgjati ma shumë. Materialin e keni para, nëse jeni për ndonjë pyetje apo konsultim, jam në disponim të ju ndihmoj.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Hapim debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë dikush fjalën?

znj.Xhilsime Qamili: A ka mundësi vetëm te neni 3 me rregullu, është shënuar me 06.01.2020. A duhet të jetë me 01.06.2020.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Unë e ceka në fillim, se materiali është punuar ma herët, sigurisht për kuvend do ta analizojmë dhe do ta korrigjojmë këtë.

z.Bekim Azizi: Unë kisha shkurt, kjo strategji çdo tri vite bëhet duke u bazuar edhe në të kaluarën, është edhe ligji që bazohet në ligj kjo. Unë kisha pas dëshirë me ditë, a keni paraparë kosto financiare ose a i keni gjetë burimet, ose a

keni fonde që parashihen për këto kategori apo është edhe kjo vetëm si strategji në letër dhe nuk mundemi me bë asgjë. Për ata desha me ditë, sa është kosto e kësaj strategjie dhe sa mundemi si komunë me e përkrahë.

Nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu: Jo, ne nuk kemi paraparë kosto financiare, do të shkojmë me kërkesa individuale. Po ju njoftoj se e kemi edhe mekanizmin kundër dhunës në familje, ku shumicën e aktiviteteve i bënë mekanizmi, ndërsa sa i përket qirasë, kryetari është merr vesh me Gjilanin për bashkëfinancim.

Znj.Hidajete Pira: Unë kisha me u ndërlidhë këtu te strategjia, këtu është cek me mbajt takime të rinjtë, vajzat , gratë, pse nuk është cek se edhe burrat duhet të mbajnë takime.

z. Heset Ukshini: Unë isha ndërlidh, se e cekët, është e vërtet se në këtë strategji nuk është paraparë. Sa i përket pagesave, nënkryetari e tha shumë mirë që kemi pasur problem, sepse nuk kemi pasur kod të caktuar për strehimore, se jemi duke pasur shumë problem, edhe se strehimoret, e kam një shumë prej departamentit që i qesin mjete për rastet e dhunës në familje. Tash e kemi paraparë që me participu edhe komuna, secila Komunë ku e ka regjionin e vetë. Isha ndërlidh pak me vitin 2020, krahasuar me vitin 2019, kemi pasur raste ma shumë, ndërsa për fat të mirë në vitin 2020 nuk kemi raste, po flas deri në kohën e pandemisë. Prandaj, unë po themë, se janë zvogëluar rastet me krahasuar me vitin paraprak. Kjo strategji nuk është vetëm për me ju ndihmu rasteve që ndodhin, por është edhe për parandalim të rasteve.

z.Ekrem Abazi: Më erdhi mirë kur tha, se në vitin 2020 është zvogëluar numri. Po më intereson prej fillimit të pandemisë, a ka pasur rritje dhe cilat kanë qenë faktorët, pse unë po mendoj se pa e ditë problemin 100% si është, por mendoj se gjendja ekonomike është një faktorë i madh.

z.Heset Ukshini: Brenda periudhës së pandemisë, them se kemi pasur 5/6 raste. Rastet që kanë ndodhur zakonisht janë raste të mëhershme, por në këtë situatë është problemi, se njerëzit kanë nejt të mbyllur në shtëpi.

z.Bekim Azizi: Unë me qëllim e ngrita çështjen e koston financiare, për me pas pak ma letë, sepse çdo rregullore që na e bëjmë, nëse ke kosto financiare e ke shumë ma lehtë me punuar, sepse nuk e ke problemin e mjeteve. 100 takime i mbajna, nëse nuk kemi mjete financiare të ndara për një çështje të caktuara, problem është zgjidhja nëse nuk ke strehimore, nuk ke ku e qon, nëse nuk ke mjete nuk ke ku e paguan një qera. Për atë unë mendoj, se në rregullore është dashtë të ketë kosto financiare, që me këtë dokument kushdo që diskuton prej komune duhet me paraparë në bazë të rasteve që janë. P.sh.: në tri vitet e fundit me ato raste me marrë një mesatare dhe me planifikuar për tri vitet e ardhshme, dhe në bazë të asaj me pas një dokument, sa do ta ketë një kosto financiare. Çdo kund që e diskuton e ke një dokument që mundesh me kërkuar për nevojat. Unë mendoj se aty ka shumë raste që hiq nuk merren vesh raste që mbulohen raste që i marrin familja biologjike. Unë mendoj se ato që vinë në takim janë raste që nuk ju del zot askush, për atë unë mendoj se duhet ta kemi edhe koston buxhetore.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Pasi nuk ka për diskutim, unë po e qes në votim. Kush është që të shkoj në kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër të rendit të ditës kemi

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft rregullores për transparencë në Komunën e Vitisë, me kërkesën e MAPL-së.

Na është rikthyer kjo për shkak të disa gabimeve teknike. Ja kaloj fjalën zyrtarit.

z.Mustaf Mehenti: As unë nuk kam diçka për të shtuar, e cek kryesuesi për një gabim teknik që e kanë bërë gjitha zyrat e informimit në nivel vendi, ju është kthyer prej MAPL-së për përmirësim.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Hapim debat. A donë ta merr fjalën dikush?

z.Bekim Azizi: A e keni diskutuar, se transparenca ka të bëjë drejtpërsëdrejti edhe me informatat që do të ketë transparencë për qasjen në dokumentet zyrtare dhe kthimi i informatës që kërkohet në afatin e caktuar, që është ligjor. A janë të parapame ato që edhe me u realizuar apo vetëm me qenë të shkrueme.

z.Mustaf Mehemti: Unë mundem edhe me cek, që në secilën kërkesë që është paraqit për Zyrën e Prokurimit, unë e kam lajmëruar me kohë z.Fadil Abazin, për afatin ligjor. Ende nuk kam marr përgjigje, kur e marr përgjigjen, unë ju njoftoj juve.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Nëse nuk ka tjerë për të diskutuar, kush është që të shkoj për miratim edhe kjo pikë e rendit të ditës. Konstatoj se u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë tjetër kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të planit komunal i menaxhimit të mbeturinave

Meqenëse pika 5 dhe 6 kanë me shkuar në diskutim publik, kisha lutë që drejtori t'i përfshi në pika të shkurtra, sepse kanë me na u kthyer prapa pas diskutimit publik.

z.Nexhmedin Jakupi: Janë dy komponente shumë të rëndësishme që janë të lidhura njëra me tjetrën. Është plani për menagjimin e mbeturinave dhe rregullorja të cilat hynë në funksion të saj. Zbatimi i këtyre dy dokumenteve, shpresoj se në një të ardhme të shkurtër do të mundësoj që ta kemi Komuna e Vitisë një ambient shumë më të pastër. Në krahasim me situatën e tanishme që e kemi, do të thotë kjo donë një bashkëpunim edhe koordinim të punëve mes komunës dhe qytetareve edhe këto dy dokumente kanë me vetëdijesu qytetarin, se duhet ta mbroj ambientin, ngase do të obligohet me paguar secili për shërbimin që e ka kryer operatori. Kjo është në pika të shkurtra. Janë dy propozime që janë me dal edhe në dëgjim publik.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Bekim Azizi: Kjo është një prej pikave ma të rëndësishme të jetës së përditshme, çështja e menaxhimit të mbeturinave, sepse çdo moment përballemi me to. Unë e kam lexuar me vëmendje, nuk munda me kuptuar qa keni menduar në fund, a e keni menduar që një kompani komunale do ta ketë menaxhimin e mbeturinave apo do të vazhdojmë me Ekohigjienën, kompania që është në funksion apo do të ja japim një kompanie private. Kyqja nuk ishte komplet në menaxhim të mbeturinave që e dim edhe ne që nuk është, mirëpo un sa e lexova, edhe te plani aty ku paraqitet parashihet që Ekohigjiena e ka paraqitur një kalkulim të vetin dhe çmimet që i keni paraqitur, të cilat konsumatorët do të jenë ata që do t'i paguajnë. Unë po e bëjë një krahasim mes asaj që kam qenë. E shohë se te një pjesë e bizneseve do të bëhet kategorizimi. Ma shumë një pjesë kam çmime të ngritura në krahasim me çmimet që i kanë, që kompanisë me këtë ju bëhet një bonus, me këto çmime që janë te ekonomitë familjare, e që ishin 5 euro. Unë mendoj se duhet të mendohet ma mirë te një pjesë e bizneseve. Po e marr shembull punuesin e orëve, orëtarin. Ai gjithë vitin 1 kg mbeturina nuk e bënë dhe ai për 12 muaj me paguar nga 7 euro, po i bjen 84 euro. Është e paimagjinueshme. Atij ma lehtë i del me i dërgu në Prishtinë, se sa kompania që vjen ja merr. Unë mendoj se duhet të bëhet diçka te kjo pjesa e çmimeve. Të ndahet pjesa, e se ke zyre të vogla që nuk qesin asnjë mbeturinë. Unë mendoj se duhet të ndahet ajo pjesë edhe duhet të bëhet një paralogaritje ma e mirë, se i keni shti 7400 familje ekonomike, here 5 euro. Kompania i ka qit harxhime gjatë vitit 170 mijë euro. Tash na masi i marrim me biznese me krejt dhe nëse 50 euro është mesatraja po i del që 400 mijë euro në vit, a ka pas me 170 mijë euro harxhime vjetore i ka. Unë mendoj se janë çmime shumë të larta në shumë kategori. Ka barazim të bizneseve, p.sh.: ETC-në me një qebaptore. Unë mendoj se duhet të behet një analizë e mirë e krejt kësaj dhe të merret shpenzimet fikse. Sa funksionin kompania, a jo në këtë mënyrë qysh bëhet menaxhimi i mbeturinave. Sot edhe nëpër fshatra bëhet vetëm rrugëve kryesore edhe në diskutim publik. Besoj se kanë me u ngrit këto çështje, por besoj që është temë që duhet të diskutojmë pak ma hollësisht.

z.Nexhmedin Jakupi: Vetëm sa për informim, plani për menaxhim të mbeturinave është bërë ma herët dhe unë kam dashtë, që në vitin 2018 të fillojmë me këtë plan. Unë dyshoja në kapacitetet që munden si komunë, me bë një plan të mirë dhe në takim që kemi pas kohë pas kohe me GIZ-in, që duhet me ju falënderuar. Ai me konsulentët e vetë e ka bërë në koordinim me grupin punues tonin gjatë vitit 2019 dhe këtë vit janë do gabime teknike. Këto pritjet të

përmirësohen gjatë diskutimit publik, ndërsa sa i përket tarifave që janë të caktuara, problemi është aty. Na problemin ma të madh e kemi si me I futë në sistem, ajo done punë.

Kryesuesi i z.Naim Pira. Meqenëse është draft dhe Bekimin e dëgjova me kujdes dhe kishte plotësisht të drejtë të kategorizimi, sepse vërtet është ashtu një orëndreqës me një vullkanizer ose me një ETC nuk mundemi me i krahasuar, por gjatë debatit me qytetar dhe në fund na vjen në Kuvend. Është mirë me i marr këto shënime apo kërkesa dhe me i shti në këtë draft.

z.Jakup Demiri: Ne kemi diskutuar për këtë temë dhe një prej pyetjeve tona ka qenë, qysh formohet kompania publike. Na kemi informat, se Deçani e ka formuar.

z.Nexhmedin Jakupi: Na kompaninë e kemi, se ajo është publiko private dhe ne kemi aksione aty. Le të merren vesh tre kryetarët e komunave, le ta formojnë një komision për ndarjen e asetëve.

z.Bekim Azizi: Unë nuk diskutova për debat, unë e diskutova në atë formën qa duhet me pas gjatë debatit. I ceka, se kam diskutuar me njerëz që janë kategori, që kanë qenë të dëmtuara, që ju ka shkuar ngarkesa dhe nuk ka pasur mbeturina. Si biznes i caktuar ju ka mbledh borxhi, se nuk ka mund ta paguaj, ndoshta i ka shkuar edhe në përmbarues. Për atë na duhet me pas kujdes, se na si kuvende e kemi për detyrë me përcaktuar çmimet, dhe na kur i caktojna çmimet, ngarkesën për qytetarë, për biznese e çka ka tjetër na duhet me matë mirë. Në këtë aspekt unë e drejtova diskutimin. Edhe në kuadër të kësaj, për këta dy muaj, a janë të ngarkuar prej Ekohigjienës apo ju vjen fatura.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Po e them edhe një herë, meqenëse ka me shkuar ne dëgjim publik dhe ka me na u kthyer edhe njëherë neve këtu. E qes në votim që të shkoj në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë tjetër të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

Pasi edhe kjo pike është e ngjashme me piken që e diskutuam. Unë po mendoj që ta qesim edhe këtë në votim. Kush është që të miratohet edhe kjo pikë me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të planit komunal i veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021

Ja kisha kaluar fjalën përgjegjësit për këtë pikë.

z.Gjeral Musa: Ky është projekt së bashku me GIZ-in gjerman dhe me përfaqësuesit e UNDP-së. Propozim vendimin e keni para jush, nëse ka dikush ndonjë konsultim jam këtu për të ju ndihmuar.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës. A donë ta merr fjalën dikush ju lutëm. Mendoj se është në interes të komunës. Këtë se prezantova para anëtareve.

z.Bekim Azizi: Nuk kam mund shumë me studiuar për shkak të materialit të shumtë, mirëpo pak a shumë do sene prej përvojës dhe e kam pasur pak ma të lehtë, është një trend interesant botëror. Efienca qëtu faqe 46, s'di çka ka menduar këtu, s'di sa keni mund me paraparë në aspekt të përgjithshëm, po e flas se na e dimë që ka qenë një trend i ndriçimit publik dhe ajo ka qenë përmes shpenzimit të energjisë elektrike. Kjo ka mund të shfrytëzohet, energjia përmes paneleve te ndriçimi. A janë dhanë ide ma të sakta edhe në shfrytëzim të ndriçimit publik. Edhe diçka, a janë të futura edhe izolimet e shtëpive? Se na e dimë se bankat jashtë kanë dhanë kredi. Vetëm desha me ditë a e keni shti edhe këtë pjesë, se kur ta marr lejen në komunë, kushtëzohet, se me pas izolim shtëpia, atëherë na automatikisht na drejtpërsëdrejti e ruajmë edhe malin, sepse konsumi druror është përgjysmë ma i vogël. Dhe në fund, pse 2019-2021, ku na gjysma e vitit.

z.Gjeral Musa: Aty nuk kemi pasur informata të sakta, e kemi qitur sa shpenzime ka. Hartimi ka filluar në vitin 2019.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Atëherë kush është që të shkoj edhe kjo pike në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon edhe kjo pikë e rendit të ditës për kuvend.

Si pike të tetë te rendit të ditës kemi:

8. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2020, dhe raporti i punës për vitin 2019

Është si komitet që e kemi themeluar ne ma herët, ata zakonisht i mbajnë 6 seanca. Nëse ka dikush me diskutuar rreth kësaj? Pasi nuk ka, atëherë kush është që të shkoj edhe kjo pikë në kuvend. Shkon edhe kjo pikë ne kuvend, dhe

Si pikë të nëntë të rendit të ditës kemi:

9. Propozim për shqyrtimi dhe miratimi e planit te punës se komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport, për vitin 2020

Kush është që edhe kjo pikë të shkoj në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si dhe pikë të fundit kemi:

10. Informatë nga Zyra e Prokurimit mbi planifikimin e prokurimeve për vitin 2020. Raporti vjetor i kontratave të nënshkruara për vitin 2019

Urdhëro Zyrtar i Prokurimit!

z.Fadil Abazi: Në raport ne i kemi disa ndryshime. Këtu janë të ndara sipas kategorive. Kategoria shërbime, janë të parapara 34 aktivitete dhe 14 aktivitete për shërbime kapitale, që kapin shifrën 1 630 140 euro. Deri tash i kemi punuar 28 aktivitete. Kemi edhe raportin janar - dhjetor 2019, janë të nënshkruara 69 aktivitete. Unë nuk dua të ju marr ma shumë kohë, për pyetje apo për ndonjë konsultim jam në dispozicion të ju ndihmoj.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Bekim Azizi: Reagimet që i ke bërë në faqen e komunës, disa parti politike po qajnë me lot krokodili, sepse kur po e japim një tender jashtë Vitisë, po thuani pse s'po e jepni në Viti, e kur po e japim në Viti, po thuani që po e jepni për fushata ose po ju jepni të afërmeve që i keni. Kontratën që e ke bërë, është fjala për pjesën e 100 mijë eurove që i kena nda për ndihma, për paket emergjente, e ke pas një reagim për atë që kemi dhanë ne vërejtjet tona, që e ke bërë. Mendoj gabimin ma të madhin moral, intelektual, kombëtar, njerëzor, shoqëror si të duash merre, ishalla edhe në këto nuk jeni të përzier për interesa tjera. Ajo pako me shkuar në cilën duash shitore del ma lirë, mirëpo çdo herë kur kemi interes për gjithçka janë bizneset e Vitisë që ju kemi ra dhe kanë ndihmuar, ndërsa kësaj radhe kur ka qenë me negocim, se kur është kontratë e hapur, konkuron kush të donë, së paku mu pas informuar bizneset e Vitisë. Ka qenë obligimi i zyrës tënde me i njoftuar bizneset e Vitisë për atë që reagojna, pse kur pe marrin të Vitisë, vetëm përcillem, gjitha janë pro ko group, nuk ka mund të hyjë askush tjetër, edhe dy apo tri firma qe i kemi, është i njëjti, përpos është vëllau i drejtoreshës, shoku i juaj që komplet i bani bashkë këto gjëra me kryetarin e juaj, me zyrën e juaj që e menaxhon Zyrën e Prokurimit. Sa për argument, vetëm shiko ka e ke prejardhjen e pareve dhe argument ma të mirë qa po donë, edhe për atë reagojna. Kurrë nuk kam reaguar që ja ke dhanë një tender një firme apo kompanie, apo diçka s'kemi reaguar asnjëherë, kurrë s'kemi reaguar që e ka marr tenderin ky për pije dhe furnizim me ushqim, kompania "Burimi". Tash do të lidhem me raportin, se deri tash isha lidh sa i përket reagimit, se kishmi qajt me lot krokodili, por kemi arsye. A janë gjitha kontratat këtu, a ka forma të kontratave që bëhen këtu, që nuk janë të paraqitura. Furnizim për zyre nga kodi

13 610, gjitha pagesat që janë analitike i kam që janë bërë pagesat, kjo nuk është askund këtu në kontratë. Media tek print, nuk është këtu comnet shpk “Blenti” ntg, prej kodit 13 610, grafo “Loni” ntg shpk 13 611 kodi , diari kodi 13 611 që nuk e ke këtu, d.m.th ti të 2017 ti i paguan në vitin 2018, a të vitit 2018 i paguan në vitin 2019. Kështu me rend, Burim F Zuka, kodi 14 440, mirëmbajtje tek ka shumë pagesa këtë vit që kanë bërë. Unë nuk e di qysh e tek, vetëm pagesat janë bërë në vitin 2019. “Metali” ntp 42 mijë euro i ka në vitin 2019 edhe kontrata e “Delfinës”, “Euro sing” kodi 13 951 7035 euro. Në këtë kod i ka të marrta, “Toni” nnp “aroma plus”, atc “kom smart” media edhe “Iliria net”, kontrata të vitit 2019, nuk kanë 19 mijë e 15 euro, janë vlera që i kanë marrë te mediat e ndryshme që i bani reklamë e botime e sene, aty shkojnë pa kontratë. Triotek i ka prej dy kodeve 8190 euro dhe 1470 euro. E kontrata për derivate, e të sigurimeve të automjeteve, arbro grupi, mirëmbajtja e rrugëve lokale, çfarë kontrate është kjo. “Euroturs” i ka 23 pagesa, i ka në vitin 2019, kontratë nuk ka, i ke edhe te transporti i nxënësve, radio taxi “Samakova”, 10 pagesa i ka në vitin 2019.

z.Fadil Abazi: Për atë ka mund me qenë kontrata në 2018. Këto që po i cek ti, janë kontrata të furnizimeve që i quajmë të kohëpaskohshme, sipas nevojës dhe kërkesave, kjo do të thotë një kontratë deri me 15 dhjetor. Ajo është kontratë e vitit 2018, a realizohet në vitin 2019, se nuk ka shpëputje aty. Edhe Burimi është i mirëmbajtjes i kompjuterëve. Ai faktikisht mundet me shënuar “Fursine Kosova”, po tash ky ndërrimi edhe kur ka hy në sistem i del emri personal. “Metali” është kontratë 36 muajshe, e cila është lidhë në vitin 2016 dhe ka përfunduar tash. “Toni” nnp, është mirëmbajtëse e objekteve të komunës dhe çdo muaj i merr pagesat, ndërsa “Aroma” ka qenë në fund të vitit 2018, ka vazhduar edhe në vitin 2019. “Smart media” edhe “Iliria net” edhe këto janë nga viti 2018. “Triotekë” ka kontratë, është furnizim me kompjutera, ata se kemi na të derivateve, ajo ka qenë në fund të vitit 2018, sigurimi i derivateve, dhe e kemi vazhduar në fund të vitit 2019. “Arbro grupi”, edhe kjo është e nënshkruar në fund të vitit 2018, është pastrimi i trotuareve e rrugëve. “Euro Turs”, është shërbim me autobus në vitin 2019. E ka fitu dikush tjetër kontratën a këto kanë qenë obligim që ju ka paguar në vitin 2019. Radio taxi “Samakova”, është kontratë e vitit 2018.

z.Hidajete Pira: Unë këtu po e lexoj, furnizim me uniforma pune, mantila për personelin e QKMF-së në Viti, diku janë harxhuar 2700 euro. Na jemi diku 110 punëtor infermier edhe doktorra. Një mantil ma i shtrajti kushton 10 euro, po llagariti kështu që i kanë marr me shumicë. Ku janë shkuar paret të tjera? Po më intereson edhe diçka tjetër. Çka më shqetësoj. Po dua me ditë ka sa i kanë blerë edhe çfarë mantila janë ata. Shqetësimi tjetër. Në seancën e jashtëzakonshme na u dashtë me nda pare ndërtimi i urës në Binçë edhe zgjerimi i Urës së Kurteshit, që është krejt gropa katastrofë. D.m.th janë harxhuar 34 mijë e 930 euro. Çka është ka ndodh? A janë sanksionuar ata njerëz a çka është puna? Furnizimi me enëlarëse dhe televizion, 820 euro. Diçka tjetër nuk kam.

z.Ekrem Abazi: Desha me ja bërë një pyetje këtij shefit. A ka tender që nuk vjedh dikush prej juve? E dyta, qëto firma që janë jo serioze psh asfaltimi 500 mijë euro vetëm me një firmë që e paska se ky ka shumë firma a mundeni kur ta bjen kërkesen , me I than nuk mundemi me ta pranë se nuk je punë kryes I mire edhe p.sh.: qeta kontraktor që kanë punuar keq, a ke mundësi po ta përsëris edhe një here, si të konkurrojnë në tender, me i thanë jo s’ke drejtë. Vetëm po ju thamë, se edhe uji I thjeshtë nuk vjen pa I vjedh këta 50%. Pse po e themë këtë. Për mua nuk është kriminel vetëm ai njeri që del e mbytet njerëz. Për mua janë edhe ata që vjedhin, p.sh.: rruga jonë, janë bërë 176 mijë euro. Tybe si kam thanë sa është trashësia e asfaltit, u duke mirë, tash kanë filluar me harrnuar. Po unë mendoj se ai njeri kurrë bukë nuk eshte ngi, duhet me fituar asfalt në Komunën e Vitisë. Na i dimë krejt, para katër vjetëve edhe sot, ka të erdhi kjo pasuri milionshe, po këta vet janë kriminelat edhe po themë edhe ujin e thjeshtë që e bien këta përgjysmë fitojnë për vete edhe pa përfitue nuk ka tender që kalon në Komunën e Vitisë. Me telefon bre kryhen këto, p.sh.: këtë rrugë ka me fituar vëllai i Fatbardha Eminit, ky dhe shokët tjerë nuk guxojnë me ja dhanë tjetër kujt. The, edhe se shumica e tenderëve shkojnë me çmimin ma të ulët. Unë po them zalli kur është shtruar, po themë, çka keni ba bre, po lloq bre është ky. Me thanë, o ti burrë, a banë me të thanë diçka, tha pash fmien mos me nguc se ma shumë kanë fitim qeta me çanta në shpinë se unë që e punojë rrugën. A ka ndonjë tender që nuk vjedhni. Mendimi im, rruga për te ne kam menduar që asfaltohet

7cm, kur e kam pa që çdo moment kur po pyes, çka je tu bë me thanë kështu duhet, kur e veta sa centimetra është, tha unë jam punëtor.

z.Jakup Demri: Rruga Skifteraj – Stubëll. Ajo rrugë është shkret, nuk ka as ngjeshje as sen. Ju kisha lut mos me më ndërhy, kur ta përfundoj mundesh me vazhduar ti. Asfalti në Smirë, tri mostra i kam marr asnjë nuk del 5cm. Rrugët që janë shtruar në Viti, asnjë nuk i kanë centimetrat që janë te shkruara në letër. Krejt këto rrugë janë duke u prishur, sepse nuk janë shtruar dhe askush nuk jep përgjegjësi. Unë e di që tenderuesi ma i lirë e fiton tenderin, mirëpo ata krejt me marrëveshje i bëjnë.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Krejt këto argumente që po i ngritni, po i bëni me një arsye të veçantë, që të përmirësohet procesi i punëve, të përmirësohet kualiteti i rrugëve. Unë mendoj se çdo anëtar i kuvendit që e ka marr votën e qytetarit e ka për obligim me i ngrit këto çështje. Unë pajtohem plotësisht me këto që i ngritën anëtarët. Fatkeqësisht po jetojmë me një realitet kosovar, që edhe për mua është i papranueshëm, se këtu janë me i shërbye qytetareve e jo me i vjedh qytetarët.

z.Ekrem Abazi: The se janë duke punuar, boll kam than edhe 4/5 herë në kuvend, që kurrë punë ma shumë nuk është bërë, por punë ma e dobët që është bërë këto vitet e fundit, historia e Vitisë nuk njih.

z.Fadil Abazi: U ngritën shumë tema, po lidhem te çështja që e ngriti Ekremi, është te na një kolegjiun edhe mbajnë takime shqetësimi i kualitetit është te krejt, edhe na po dojmë zgjidhje ligjore, sepse na e kemi këtë që me fituar me kriterin ma të ulët.

z.Ekrem Abazi: Mua nuk më intereson për tjerat komuna, unë jam ka flas për Komunën e Vitisë, se këtu janë nja 4/5 llopova që kanë bërë pasuri marramendëse në djersë të qytetareve.

Kryesuesi i z.Naim Pira: Me kaq mbylli mbledhjen. Mirë u pafshim në takimet e ardhshme.

Seanca përfundon punimet në ora 12: 30 minuta

Procesmbajtësi:

Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë

z. Naim Pira
